TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

RUST PROTECTION ENAMEL

BOJË ANTI KORROZIVE 3 NË 1

PËRSHKRIMI TEKNIK

RUST PROTECTION ENAMEL është një produkt i ri novator me bazë solventi, i përshtatshëm për mbrojtjen e lartë të të gjitha sipërfaqeve metalike. Kombinon 3 produkte në 1: bojë përfundimtare, astar anti korroziv, astar special për aplikim direkt në ndryshk. Mbrojtje e lartë ndaj kushteve të motit dhe rrezeve UV, për të gjitha sipërfaqet. I përshtatshëm për mbrojtjen e aplikimeve zbukuruese në ambiente të brendshme dhe të jashtme dhe në ambiente industriale.
Është i disponueshem në 16 ngjyra të gatshme dhe mund të përgatitet në të gjitha ngjyrat e katalogut RAL.

CILËSITË

Është i fortë dhe shfaq rezistencë të lartë ndaj rreziqeve mekanike. Rezistencë e lartë ndaj kushteve të vështira të motit, pastrimit intensiv, përdorimit të gjatë dhe lagështisë. Ngjyra dhe niveli i lartë i shkëlqimit ruhen të paprekura për një kohë të gjatë. Gjithashtu, disponon elasticitet të lartë dhe si rrjedhim është rezistent gjatë punimit të drurit. Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistolete

FUSHA E APLIKIMIT

Mund të përdoret për dekorim si dhe për mbrojtje anti korrozive të sipërfaqeve metalike, të cilat janë të ekspozuara në ambjente të rënda si psh., instalime detare dhe bregdetare, industriale, etj.
Aplikohet në ambiente ku nevojitet mbrojtje e lartë antikorrozive si: kulla elektrike, fabrika kimike, makineri, binare urash rrugore/hekurudhore, dyer metalike, anije, pajisje metalike, kangjella, etj.
Gjithashtu mund të aplikohet në lodra druri dhe në objekte dekorative prej druri dhe metali.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/i (Bojra specifike me një komponent): 600g/l (2007) dhe 500g/l (2010). Ky produkt përmban maksimalisht 480 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

RUST PROTECTION ENAMEL

BOJË ANTI KORROZIVE 3 NË 1

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër, e thatë, pa praninë e shtresave të vjetra të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, etj. Pastroni sipërfaqet me special CLEANER No 500 të **ZEUS-AL**.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me BRUSH SOLVENT No 100, sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-10 % me SPRAY SOLVENT No 200, sipas peshës.
Aplikimi: Aplikoni 2 – 3 duar në sipërfaqen e pastruar mirë.
Nuk është e nevojshme të përdoret primer anti korroziv.
Për sipërfaqe alumini ose të xinguara: Aplikoni në fillim 1-2 duar WASH PRIMER.
Temperatura e aplikimit: 5 deri 35°C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: Të gjitha ngjyrat RAL & 16 ngjyra të gatshme.
Shkëlqimi, në 60°: 80±5 (ELOT EN ISO 2813-99)
Densiteti: 0.95 – 1.20 ± 0.01 gr/ml në varësi të ngjyrës (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti, DIN 6, at 25°C: 60-80 sec (ISO 2884.02-03)
Viskoziteti në aplikim me pistoletë 4mm: 18-22 sec(ISO 2884.02-03)
Substanca të ngurta, sipas peshës, %: 63±2 (ELOT EN ISO 3251-03)
Koha e tharjes,në 25°C:

- Tharje sipërfaqësore: 20-35 minuta
- Tharje në prekje: 2-3 orë
- Tharje e plotë: 16 orë
- Rilyerje: pas 16-24 orë

Pika e ndezjes: 25°C (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në metal (ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Ngjitja në WASH PRIMER (ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Fortësia (Könnig): 55 ±5 pas 7 ditësh (ELOT EN ISO 1522-00)
Elasticiteti (testi i Mandrelit): 3±1 mm passes (ELOT EN ISO 1519-02)
Mbulimi: 9 - 10 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura mirë.

PËR APLIKIMIN ME PISTOLETË
Përdoreni gjithmonë në ambiente të ajrosura mirë duke përdorur maskë dhe doreza të përshtatshme për mbrojtje. Mos i thithni avujt.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com